

Nuk di saktë cila nga bi-sedat e shumta të ditës ma nxitu kujtesën mbi traditën e mençurisë popullore. (Po me siguri, tema ka qënë rreth tullumbaceve të gaze-tave opozitare mbi... «pje-sën e ndriqar dhe të pa-ndriqar të vendit»).

Të them të drejtën, si bir fshatari, ndodhesh i fyer kur pseudo- intelektualë të marrosur nga ethet pas-elektorale, hedhin baltë mbi djepin e kulturës më të her-shme e më të respektuar të çdo kombi.

Zotërinjë politikanë, me nishanë e me ofiqe, kujtoni porositë e mendimtarit to-në të madh, Sami Frashë-rit: «Njeriu fisnikëron ve-ten kur thotë të vërtetën dhe në kulmin e zemërimit».

Dhe për hir të kësaj të vërtete le të kujtojmë disa këshilla nga thesari i men-curive të shumta të fshata-rit se si duhet ta presim e t'i flasim kohës së ditëve to na.

«Fatkeqësitë e mëdha ly-pin zotësi të mëdha». A nuk mëson fshatari ynë. A nuk është ky një mesazh kohor për punë, për djersë, për rimëkëmbje të ekonomisë, për trimëri, maturi e pje-kuri drejt progresit të ni-

URTIA E FSHATARIT - MENÇURI QE I FLET KOHES

veleve të bashkëqytetërisë së sotme evropiane që sy-nojmë e dëshirojmë? Fsha-tari merret me punë e jo me fjalë, dhe, aty ai sheh u-dhën e ngritjes të mirëqë-nies pasi ka parasysh kë-shillën që i kanë përcjellë të parët dhe na i mëson edhe neve që, «fjalë po të shtosh mbi fjalë, edhe detin e bën dhallë»!...

Universi i kthesave, luft-rave, vështirësive fshatarin e ka bërë filozof modest, te-jëpamës e të panxituar për t'u rrëmbyer sepse ka para-sysh mençurinë e logjikës së vet shekullore: «Kush të lyen e kush të lan, kush a-vazin ty ta mban, të bën varrin e të qan!... - Mund të na pëlqejë zëri, - thotë pje- kuria e fshatarit - po s'di-më si është gjëri?!...». Ai mullirin e çmon, jo nga zhurma, po nga mielli.

Shumë flitet se kush ka zgjuar njëri - tjetrin, qyteti fshatin apo fshati qytetin? Unë mendoj se ai që ka zgju-ar më herët punën ka zgju-ar dhe intelektin se puna ka mësuar njerinë. Respekt vë-llezër, për djepin më të her

shëm të mendjes. Ju për-shëndes. si i moshuar, juve të rinj të kulturuar të rre-thit tim që e kini treguar veten të respektuar e pa-eksese në këto procese të vrullshme të demokratizimit të mëtejshëm të jetës së ve-ndit. U këshilloj të mësoj-më e të armatosemi gjith-një e më shumë me dijet që reflekton tradita e mençurisë popullore e fshatarit tonë, pavarësisht nga bindjet po-litike. Urtësia e tij na flet: «Të bashkojmë duart tona, të mbrujmë bukën tonë e të mos përsheshim në kushinë e botës!». Urtësia kombëtare na bën thirrje: «Të mos mprehim mëritë po të zgjo-jmë dashuritë!».


Vetëm kështu, njësoj, shoq-ptarisht të dashuruar e të ndriquar, do të gjejmë u-dhën e vërtetë të qytetëri-mit plot mirënjohje për nje-ri - tjetrin. Mirënjohje të pakufishme t'u ushqemë brezave, jo vetëm për djer-sën po edhe për fisnikërinë e mençurinë e fshatarit. S'ka ligësi më të madhe në botë se mosmirënjohja.

MALIQ LILA

Fotoreportazh

NGA THEODHORI BRUZHË

TEPELENA: 16 PRILL 1991



Tepelena, qyteti ynë i dashur, po bën të fundit, që do të shur! Sa shumë vend zuri mbeten si një kujtim për në tre vjet - jetën e «Laj-mëtarit». Jo vetëm me shkri-na e pranverës të vitit 1991, me, por edhe me foto: Kë-

TAIP XHIHANI

Filloi shpërndarja e ndihmave të para

Ka disa ditë që Kryqi i Kuq i rrethit po shpër-ndan kontingjentin e parë të ndihmave që i kanë ardhur vendit tonë nga shoqatat e vendeve fqinje. Këto janë këpuce për fëmijë të ardhur nga Kryqi i Kuq i Gre-qisë. Të parët që i veshën janë jetimët dhe fëmijët e familjeve me të ardhura e-

konomike të pakëta.

Kërkesat për ndihmën tonë si shoqatë e Kryqit të Kuq janë të shumta dhe nuk mund të plotësohen lehtë. Prandaj këshillat e kësaj sho-qate duhet të kujdesen për të njohur më mirë gje-jndjen konkrete të invalidë-ve, kërkesat e tyre për ve-shje, karrike lëvizëse e tje-

ra pajtaje si dhe nevojat e të moshuarve të vetmuar, të jetimëve, nevojat e çerdhe-ve, të kopshteve, institucio-neve mjekësore e mbi këtë bazë të bëhen kërkesa të studjuara dhe jo mbi bazë konsideratash personale.

MUHARREM SALIAJ
HAJRI HYSENI

SPORT

Mbrojtja mëson sulmin si shënohet goli

«Ylli i Kuq» i Pogradecit kishte ardhur në Tepelenë me pretendimin e marrjes së një barazimi, qëllim që u duk me lojën e tij mjaft të kujdesëshme në mbrojtje e kundërsulme. Siç dihet e- kipi mik është kampion i fazës së parë, dhe vendin e nderit ende e mban me lojë korrekte, teknike e me theks sulmues. Por këtë herë në Tepelenë, ashtu sikundër e- dhe në fazën e parë të ka-mpionatit futbollistik me «Minatorin» e Memali-ajt, ndeshi përballë sku-adrës së fortë, të përgatitur mirë fizikisht e taktikisht nga treneri Mihal Çimi.

Qysh në fillim u pa syni-mi e të dyja ekipet. Ve-ndasit kërkojnë të shënojnë ndërsa miqtë luajnë me mjaft kujdes e siguri në mbrojtje. Sulmet e «Mina-torit» janë të drejtuara mi-rë nga krahët e qendra, kro-simet pasojnë njeri - tjet-

rin por goli ende nuk du-ket. Kështu afrohet e për-fundon pjesa e parë e nde-shjes. Rastet e mira nuk u shfrytëzuan nga sulmuesit tanë, jo shumë për nxitim sesa për mungesë përgatitje teknike të tyre. Në pushim të dy trainerët siç duket dhanë porositë, bënë vërej-tje e kritika por menduan e- dhe për disa koregjime që duheshin bërë në lojën sul-muese. Më e theksuar kjo për «Minatorin» Themë se ndodhi kështu sepse qysh në fillim të pjesës së parë e në vazhdim vetëm portieri ve-ndas Qiqi nuk e kaloi vijën ndarëse në mesfushë. E gji-thë skuadra është në sulm.

E kemi parë qëndërmbrojtë-sin Vladimir Muci edhe në role të fshehta si mesfushor e organizator edhe herë të tjera. Por këtë radhë ai ishte shpirti i ekipit dhe më i mi-ri në fushë. Disa herë kro-simet nuk japin rezultat e-

dhe për organizim e vendo-sje të rregullt të kundër-shhtarit në mbrojtje po edhe se sulmuesit Zotaj, Ruçi e Nelaj nuk e gjejnë dot rru-gën e rrjetës. Këtë e vëre- mirë vetë Ladi që në të 77-ën, minutë një krosim nga këndi e kthen në gol që ngrii peshë shikuesit me a-të kërcim të shkëlqyqer me kokë. Një me zero. A thua se do të shohim edhe gola të tjerë? Jo, është përgji-gja sa rruga e golit këtë ra-dhë ishte mjaft e fshehtë për repartin e mesfushës a atë të sulmit.

Një mësim të mirë për këtë dha mbrojtja. Fitorja ishte plotësisht e merituar dhe natyrisht për të punuan të gjithë. Tash ata mbajnë vendin e dytë në tabelë. Memalotët në Përmet siç u njoftuan barazuan 0:0.

Adresa e redaksisë: Prand Komitetit të Partisë të rrethit. Tel. 248

PROLETARE TË TË GJYMA VENDIME BASHKONIMI!

Lajmëtar

ORGAN I KOMITETIT TË PARTISË TË RRETHIT TEPELENE

VITI i 4-t

Nr. 16 (164)

E martë, 16 prill 1991

Çmimi 20 qindarka

Luftëtare e progresit

Kaluan pak më shumë se tre vjet që kur doli numri i parë i gazetës «Lajmëtar», organ i Komitetit të Partisë së rrethit dhe publiku i Tepelenës ndjeu një gëzim të veçantë. Dhe kishte të drejtë, gazeta do të ishte biografia dhe kronika e për-javshme e tij, lajmërujesja e gëzimeve sukseseve, por dhe shqetësimeve që kishte rre-thi, propaganduesja e arrit-jeve më të mira të tij, nxi-tësja e masave për të dhë-në kontributin e tyre për të mirën e përgjithëshme, pro-paganduesja e traditave më të mira të popullit të Tepe-lenës dhe edukuesja kolekti-ve e masave me frymën e patriotizmit, e dashurisë për punën, për shokun dhe e gji-thkaje të mirë e të dobish-shme për popullin.

Sot më datën 16 prill 1991 del numri 164 i saj, dhe me-gjithëse nuk na e zë goja ta themi, numri i fundit i «Lajmëtarit».

Gjatë kësaj periudhe tre vjeçare gazeta e justifikoi plotësisht misionin e vetë. Njëpërmyet faqeve, të gati dy mijë kopjeve të saj, tepele-nasit jo vetëm brenda, por dhe jashtë rrethit ndiqni

me interesim të veçantë je-tën e tij, ndjenin dinami-kën e ecjes së tij, gëzohe-shin për sukseset, por dhe shqetësoheshin për punët që nuk shkonin mbarë. Për kë-të flasin jo vetëm takimet e shumta të redaktorëve të ga-zetës, korrespondentëve dhe bashkëpunëtorëve të saj vu-llnetarë në të katër anët e rrethit, por dhe dhjetra le-ttra që i kanë ardhur gjatë kësaj periudhe redaksisë nga lexuesit e saj tepelenas nga Lushnja, Korça, Tirana, Du-rrësi, Fieri, Shkodra e rre-the të tjera të vendit.

Populli i Tepelenës e do-nte dhe e do gazetën «Laj-mëtar». Ai e vlerëson atë si një tregues kulturor të rre-thit. Kurrë ai nuk ka qënë se i rixhi ndaj materialeve dhe rubrikave të gazetës. Përkundrazi, ai i ka qënd-ruar shumë afër dhe ka dhe-në një ndihmë të çmuar redaksisë së vogël prej dy ve'ash, me mendime, sugje-rime, por dhe me kritika për ato probleme që gazeta nuk i kapte ose nuk i trajtonte ngandonjëherë drejt. Pse i-shte kjo lidhje me masat gazeta nuk e ka ndërjer ku-rrë ngushtë veten për ma-

teriale, për bashkëpunëtorë e korrespondentë vullnetarë. Për këtë flet nga ana tjetër dhe fakti që për nga tirazhi ajo zë vendin e parë midis gazetave të rretheve të ka-tegorisë së Tepelenës dhe ua kalon shumë rretheve të ka-tegorisë së parë.

Vendosja e një shoqërie pluraliste në Shqipëri, e ci-la sapo ka filluar të hedhë hapat e saj të para, dhe shkëputja e gazetës nga di-sa klishe partiake, pa dy-shim, do t'i krijojnë asaj a-vantazhe të reja dhe mur-ndësi për t'u pasqyruar më e plotë e më e larmishme jeta e popullit. Por fatke-qësisht ekonomia e tregut nuk e kurseu as shtypin.

Redaksia e gazetës ka bi-tindjen se tepelenasit, inte-lektualët dhe njerëzit e thjeshtë në një të ardhme të afërt, do t'i gjejnë mu-ndësitë për t'ia rikthyer po-pullit këtë pasuri kulturore, këtë ushqim të përjavshëm shpirtëror që varfëria na e largoi nga jeta jonë. Dhe «Lajmëtar», luftëtar i pro-gresit, do të jetë përsëri pranë nesh.

JORGO ZHONGA
Kryeredaktor

NJOFTIM

Më orientim të KQ të Partisë Punës së Shqipëri-së, duke filluar nga data 16 prill 1991 nuk do të dalë më gazeta «Lajmëtar» si-kundër nuk do të dalin dhe gazetat e 17-të rretheve të tjera të vendit tonë. Do të vazhdojnë të dalin gazeta-bazë qarku por jo si organe të Komiteteve të Partisë të rretheve. Rrethi ynë do të gjejë veten në gazetën që do të botohet në Gjiro-kastër për katër rrethet e jugut. Kjo masë merret për faktin se të ardhurat që si-gurohen nga pajtimet në ga-

zetë, janë shumë më të ulta nga shpenzimet që bëhen për përgatitjen e tyre dhe kryesisht nga shpenzimet e shtypjes të cilat deri tani përballoheshin nga shteti.

Me këtë rast redaksia e gazetës falënderon gjithë ba-shkëpunëtorët korrespon-den-të vullnetarë, lexuesit e saj dhe punonjësit e palo-dhur të shtypshkronjës së Gjirokastrës për ndihmën e tyre të çmuar për përgatit-jen dhe daljen e gazetës për këto tre vjet të jetës së saj.

REDAKSIA E GAZETES

E ardhmja



Fëmijët tanë të çliruar nga hallet e mëdha të ko-hës qeshin e lojrojnë të lumtur.

Kemi të gjithë detyrë të kujdesemi për ta, për mi-rërritjen e tyre. Janë e ardhmja jonë, e ardhmja e At-dheut.

MINIERES I KA LËZET RINIA

- Shënime e mbresa -

krifika më e lartë duket e zakonshme.

Po i hedh në këtë shkri-m ca shënime të fundit.

Zbritem para disa ditësh në një nga llavat e sek-torit të Pusit Nr. 3 me in-xhinierët Robert Mamaj e Ymer Sinar. Ishte edhe in-xhinieri Faik Çinaj, të cilin jeta e kemi deputet. Për të vajtur në front, tek llava-na u desh të ulnim kokën e të kërruseshim disa herë. Me vete mendoja: Vetëm miniera s'pyet për ofiqe e poste. Ajo të detyron të përulësh, do apo s'do ti. Në fakt është përulja për ma-uhësininë e punës së këtyre njerëzve, nderimi për ta.

Në llavën - 88/5 veri, Ha-te Dashi, di të presë shokë.

Unë që e njoh nga afër kur shikoj se është bërë zjarr-mëtar më shkon mendja tek breznitë që zëvendësojnë njëra - tjetrën. Ka që zjarr-mëtarë janë djem të rinj po kjo lidhet me shkollën pro-fesionale që kanë bërë. Të tjerët për të marrë çantën e zjarrmëtarit zakonisht u du-het të japin shumë si mi-natorë prodhimi. Dhe Hat-ja ka punuar jo pak, me-gjithëse është ende i ri. Po veten si minator e ka zëve-ndësuar me djelmohat 28 vjeçarë Jorëji Korrovëshi e Skënder Kalemli që i kanë

dalë zot frontit. Sa mirë -thua. Minierës i ka lezet ri-nia. Dhe më vjen ndërmend Manol Todhe që tani është përgjegjës turni në avan-cimet e këtij sektori. Është nga ata njerëz të punës që sic thonë, ta pish në kupë, Dikush thotë se në rininë e hershme ka qënë i vështirë, biles këtë ma ka thënë edhe vet Manoli, diku në një ba-llë të frontit. Tani ai është drejtues, turni. Hallall, ta ketë. Aq më tepër që Ma-kxim Sotiri, përgjegjësi i sektorit më thotë që është turni më i mirë. Dëmos, Njeriu që vet i ka vënë pu-nës gjoksën s'ka pse të le-jojë që të tjerët t'i kthejnë shpinën.

6 Prill 1991. Në sipërfaqen e sektorit të pusit Nr. 2 për-jetoj marrjen flakë të bun-kerëve të ngarkimit të qy-

(vijon në faqen 3)

